

Përmbajtja e portofolit të kualifikimit

Portofoli i çdo mësuesi të kulturës profesionale, kandidat për çfarëdo kategori kualifikimi, përbëhet nga dy pjesë:

1. Pjesa me të dhënat personale;
2. Pjesa me përmbajtje profesionale;

I gjithë dokumentacioni i portofolit të kualifikimit përgatitet nga kandidati në format elektronik (pdf) dhe dërgohet me e-mail në adresën info.kualifikimi@akafp.gov.al dhe brenda afatit të përcaktuar nga AKAFPK.

I. Pjesa e portofolit me të dhënat personale të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara):

1. Fotokopje e dokumentit identifikues (pasaportë ose kartë identiteti ose leje drejtimi e mjetit) (**e detyrueshme**).
2. Jetëshkrimin në gjuhën shqipe, sipas formatit të Europass (**i detyrueshëm**).
3. Certifikatat e trajnimeve të akredituara të kryera, me kreditet e fituara (të paktën 5 kredite për kategoritë "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist", si dhe të paktën 9 kredite për kategorinë "Mësues mjeshër") (**të detyrueshme**).
4. Certifikatën e kategorisë (shkallës) së kualifikimit të fundit që zotëron, për kategorinë "Mësues specialist" dhe "Mësues Mjeshër" (**e detyrueshme**).
5. Certifikatat e trajnimeve të tjera, që lidhen me mësuesin ose profesionin, të kryera gjatë periudhës së kualifikimit (**nëse ka**).
6. Vërtetimin që tregon se kandidati është bashkëpunëtor (specialist i jashtëm me kontratë) i AKAFPK (**nëse është i tillë**).
7. Dëshmitë e titujve/gradave shkencore të fituara (**nëse ka**).
8. Vërtetimin, **nëse ka kryer**, në periudhën e dy viteve të fundit, të paktën 3 (tre) ditë stazh (praktike) në fushën profesionale përkatëse, në një institucion publik apo biznes privat. Vërtetimi duhet të jetë i vërtetuar dhe firmosur nga drejtori i ofruesit të AFP dhe nga përfaqësuesi i institucionit/biznesit.
9. Dëshmi të zotërimit të gjuhëve të huaja (**nëse ka**).

II. Pjesa me përmbajtje profesionale e portofolit të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara), ku evidentohet edhe emri e mbiemri i kandidatit:

1. Planin e mësimit të një lënde teorike profesionale ose të një moduli të praktikës profesionale, që e jep mësuesin (**i detyrueshëm**).
2. Plan-ditarin e një seance mësimore teorike, bazuar në mësuesin, me prezencë fizike dhe atë online, ose plan-ditarin e një seance mësimore praktike me prezencë fizike (**i detyrueshëm**).

3. Formulimin e një objektivi mësimor specifik, teorik ose praktik (**i detyrueshëm**).
4. Një instrument për vlerësimin e njohurive ose shprehive të nxënësve apo kursantëve (test teorik me të paktën 5 njësi testi të ndryshme ose listë kontrolli për shprehitë praktike me të paktën 5 kritere vlerësimi) (**i detyrueshëm**).
5. Një material mësimor për nxënësit/kursantët, për një çështje teorike (**një faqe A4**) ose një udhëzues pune për një aftësi praktike (**i detyrueshëm**).
6. Një prezantim (në PowerPoint) për një çështje teorike ose praktike (jo më pak se 3 slajde dhe jo më shumë se 6 slajde) (**i detyrueshëm**).

Dokumentet duhet të renditen sipas radhës së renditur më lart dhe në çdo faqe të dokumenteve të shënohet si “footer note” emri dhe mbiemri i kandidatit për kualifikim.

Për arsye të kapacitetit të madh të dokumenteve, çdo kandidat mund t’i dërgojë ato me dy e-mail-e, duke i ndarë dokumentet sipas pjesëve të paraqitura më lart (Pjesa e portofolit me të dhënat personale dhe Pjesa e portofolit me përmbajtje profesionale) ose me më shumë e-mail-e në varësi të numrit të dokumenteve që posedoni.

Dokumentet e listuar më lart dhe të përcaktuara në nenin 5, pika 3/a, 3/b dhe pika 4, të Udhëzimit 21, dt.27.6.2022, janë dokumente të detyrueshme, mungesa e të paktën njërit prej tyre, e përjashton kandidatin nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.